



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 427/2 prot

Datë 23.02.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME.**

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me REF-93394-01-18-2024, me objekt: “Blerje materiale mjekësore” me fond limit 1,474,160 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetsore e Specialiteteve nr.1, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK, me Nipt. *K51612031J dhe Adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Z. Kadastrale 2105, Nr. Pasurie 95/11, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Shëndetsore e Specialiteteve nr.1, Tiranë
Adresa: Rr. “Vllazën Huta”, Tiranë.
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, me Nipt. *L81512021D dhe Adresë: Rr.Don Bosko, Blloku Nr.1, Shkalla Nr.3, Kati I, Nr.4. Tiranë.*

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK me numër ankimi elektronik A/2024/3817, datë 21.02.2024, dhe me nr. 427/2024 prot., datë 22.02.2024 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-93394-01-18-2024, me objekt: “Blerje materiale mjekësore” me fond limit 1,474,160 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetsore e Specialiteteve nr.1, Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “TRIMED” SHPK në ankesën me nr. 427/2024 prot., datë 22.02.2024, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “AQUARIUS MEDICAL” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje të kriterit si më poshtë vijon:

“Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “TRIMED” SHPK kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, me pretendime se: Operatori AQUARIUS MEDICAL nuk disponon Licensë II.7.B.1 – “Për Tregtim të Barnave”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 23.02.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri